KOMUNIKATË PËR MEDIA

Evoluimi i Sistemit të Prokurimit Publik të Kosovës

31 janar 2023

Të gjitha vendimet e autoriteteve kompetente të prokurimit publik, duhet të jenë rezultat i punës profesionale, transparente, efikase dhe llogaridhënëse. Ky është një synim që Organi Shqyrtues i Prokurimit të Kosovës (OSHP) angazhohet që ta perfeksionoj me lansimin e Sistemi të ri të Menaxhimit të Lëndëve (SML).

SML-ja do ta lehtësojë dhe avancoj këtë proces duke i mundësuar OSHP-së që t'i menaxhojë ankesat e operatorëve ekonomikë në mënyrë më efektive, duke përzgjedhur në mënyrë *të rastësishme* ekspertët shqyrtues dhe anëtarët e panelit dhe duke përcjellë progresin e ankesave.

Mandati ligjor i OSHP-së konsiston në kompetencat ligjor për shqyrtimin e të gjitha ankesave të ushtruara nga operatorët ekonomik në lidhje me vendimet e autoriteteve kontraktuese. Vjosa Gradinaj Mexhuani, Kryetare e OSHP-së ka theksuar se "Ky modul i ri në sistemin e prokurimit elektronik është një hap i rëndësishëm në evoluimin e prokurimit publik të Kosovës".

Krahas tjerash, SML do t'i do ta llogarisë po ashtu edhe afatet për dorëzimit të ankesave sipas Ligjit për Prokurimin Publik dhe do t'ua rikujtojë ekspertëve dhe anëtarëve të panelit shqyrtues afatet ligjor në kuadrin e të cilave kërkohet nxjerrja e vendimit meritor. Përveç kësaj (për shkak të sistemit automatik të punës) SML do t'i zvogëlojë gabimet eventuale në aktet përfundimtare (vendime, urdhra) të OSHP duke i plotësuar automatikisht aktet e cituara me informacione, të cilat kanë të bëjnë me tenderët e publikuar në sistemin elektronik të prokurimit publik të Republikës së Kosovës. Një tipar i rëndësishëm i SML-së do të jetë dorëzimi i ankesave në një format të lexueshëm dhe më të qartë duke i lejuar Bordit të OSHP-së që t'i kërkojë të gjitha ankesat e pranuara dhe vendimet e marra në secilin rast, dhe rrjedhimisht duke i lejuar OSHP-së t'i konsultojë në rastet e nevojshme vendimet e mëparshme dhe kështu të sigurojë konsistencë në tërë këtë proces.

SML është zhvilluar si pjesë e Projektit për Forcimin e Prokurimit Publik në Kosovë (FPPK), që financohet nga Ambasada Britanike në Prishtinë dhe zbatohet nga DAI Global UK. Projekti FPPK do të vazhdojë ta mbështesë OSHP-në gjatë vitit 2023 për ta rritur transparencën, efikasitetin dhe besueshmërinë në procesin e vendimmarrjes.

Për më shumë informata mbi SML-në, ju lutemi vizitoni: https://oshp.rks-gov.net/ dhe https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx